



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

## BULETINI MUJOR I SEMUNDSHMERISE INFEKTIVE (Pasqyra 14 Sh)

SEKTORI I EPIDEMIOLOGJISE

MARS, 2018

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Epidemiologjisë, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Ai plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 të çdo muaji. Te dhënat e agreguara të pasqyrës 14 sh për muajin Mars janë të dhënat e raportuara nga të 36 rrethet e vendit.

### ➤ Semundjet diarreike

Gjate muajit Mars 2018 sëmundjet diarreike paraqesin një incidence 166.67/100.000 banore. Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozes jotifoide dhe Shigelozes për muajin Mars 2018 në nivel kombëtar përkatësisht 1.5/10.000 banore dhe 2.47/10.000 banore. Vlen të përmendet prekja e moshave femnore përkatësisht < 1 vjeç dhe 1-4 vjeç. Duke ju referuar raportimeve të toksikoinfeksioneve alimentare gjate muajit mars 2018 në nivel kombëtar incidenca është 3.32/100.000 banore. Rrethet Berat, Bulqizë dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e toksikoinfeksioneve alimentare. Te gjitha rastet janë sporadike, nuk kanë patur lidhje epidemiologjike me njeri tjetrin dhe nuk kanë qene pjese e ndonjë shpërthimi. Incidenca e gastroenteriteve të paspecifikuara në nivel kombëtar është 160.99/100.000 banore. Gastroenteritet e paspecifikuar janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit.

### ➤ Zoonozat

Tabela 1: Shpërndarja e zoonozave, numri total i rasteve dhe incidenca (Brucelozë, Antraks, Leptospirozë, Tbc ekstrapulmonar, Rikecie) në muajin Mars 2018

	Mars (Raste 2018)	Incidenca (raste/100,000) 2018
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	9	0.3
Leptospirozë	1	0.04
Tbc ekstrapulmonar	6	0.2
Rikecie	0	0


Në nivel vendi incidenca e Brucelozës është 0.3/100.000 banore. Rastet për muajin Mars 2018 janë raportuar nga rrethet Dibër, Gjirokastrë, Pogradec, Kuçovë, Sarandë dhe Skrapar. Antraksi dhe Rikeciet rezultojnë me 0 raste

raportimi për muajin Mars 2018. Nga të dhënat e raportuara në muajin Mars 2018 rezultojnë 6 raste me TBC ekstrapulmonar dhe janë raportuar nga rrethet Durrës, Shkodër, Tirane, Fier, Gramsh.

### ➤ Fruthi

Gjate muajit Mars 2018 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë konfirmuar me IgM pozitiv 292 raste nga 539 raste që janë dyshuar në total. Rastet janë konfirmuar në Laboratorin e Virologjisë, ISHP.

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve pozitive, negative dhe të dyshuara me fruth sipas ditëve.




Rastet i përkasin kryesisht moshës pediatrike (<1 vjeç) moshe që sipas kalendarit të vaksinimit nuk e ka kryer dozën e parë të FRP. Peshën kryesore sipas shpërndarjes gjeografike të rasteve të dyshuara dhe të konfirmuara me fruth e mban Tirana, Lezha, Kukësi dhe Durrësi.

### ➤ Meningoencefalite

Gjate muajit Mars 2018 janë raportuar në total 7 raste me meningoencefalite ku peshën më të madhe e mban meningjiti bakterial jo meningokoksik dhe encefaliti i paspecifikuar, përkatësisht 2 dhe 3 raste.

Grafiku 2. Totali i rasteve të dyshuara me meningoencefalite gjatë muajit Mars 2018




Në lidhje me totalin e meningoencefaliteve në Mars 2018, shpërndarja e rasteve sipas gjinisë është në raportin 4: 4, me predominim në grupmoshën pediatrike 1-14 vjeç

### ➤ Hepatitet virale

Në raportimin mujor të semundshmerise infektive gjatë muajit Mars 2018 janë raportuar në total 24 raste me hepatite virale akute nga të cilat 6 (25%) raste janë Hepatite virale të paspecifikuar dhe 17 (70.8%) raste me Hepatit viral akut B.

Grafiku 3. Numri i rasteve me Hepatite virale akute, Mars 2018



Hepatit viral të paspecifikuar gjatë muajit mars 2018 kanë pothuajse të gjitha grupmoshat, me përjashtim të grupmoshave 0-4 vjeç dhe mbi 60 vjeç. Në lidhje me HBV, 11 rastet (64.5%) raste i përkasin moshës 25-44 vjeç, 4 (23.5%) raste grupmoshës 45-59 vjeç dhe 2 (11.8%) raste grupmoshës mbi 60 vjeç. Në grupmoshat pediatrike nuk kemi raste të raportuara si për Hepatitin B ashtu edhe as A as B. Në lidhje me gjininë vëmë re se kemi predominim të rasteve të meshkujt.

### ➤ **Tuberkulozi pulmonar**

Gjate muajit Mars 2018 janë raportuar 23 raste me Tuberkuloz pulmonar dhe vihet re nga te dhënat e ardhura ne ISHP qe peshën me te madhe te rasteve e mban Tirana dhe Lushnja dhe grupmosha 15-65 vjec.

### ➤ **HIV/AIDS**

Duke u mbështetur ne te dhënat e Programit Kombëtar te HIV/AIDS janë diagnostikuar 11 raste HIV pozitive ne muajin Mars 2018. Shpërndarja sipas gjinisë e rasteve te muajit Mars 2018 është përkatësisht 8 raste janë meshkuj dhe 3 raste janë femra. Ne muajin Mars 2018, 5 raste i përkasin grupmoshës 25-45 vjeç dhe grupmoshës mbi 45 vjeç. Vetëm një rast i përket grupmoshës 0-15 vjeç. Shpërndarja gjeografike e rasteve te konfirmuara me HIV gjate muajit Mars 2018 janë: 8 raste ne Tirane dhe përkatësisht nga një rast ne Kruje, Laç dhe Elbasan. Duhet te theksojmë qe këto janë te dhënat e ardhura nga Shërbimi i Infektivit, QSUT, Banka e Gjakut apo nga VCT e rretheve ndërsa Survejaca e SMBS ne lidhje me diagnozën AIDS paraqet zero raste te raportuara nga rrethet përkatësisht ne muajt Mars 2018.

Hartoi: **Departamenti i Kontrollit te Sëmundjeve Infektive, Sektori i Epidemiologjisë.**

Silvia Bino, Eugena Tomini, Artan Simaku, Adela Vasili, Luljeta Alla, Elona Kureta, Rovena Daja, Marjeta Dervishi.

Editoi: Rovena Daja

INSTITUTI I  
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI